

Syllabusi

Lënda: Gjuhe shqipe

Programi i studimit: *Studime Islame*

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 104

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2015-2016

Semestri: -I-rë

Mësimdhënësi: Dr. Nexhmije Kastrati

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Plotësime lidhur me njohuritë e studentëve për shqipen standarde dhe për drejtshkrimin si dhe për problemet e ngritura kohët e fundit.

Ngritja e kulturës së gjuhës në përgjithësi dhe e kulturës së shkrimit duke mbajtur parasysh pasurimin e leksikut dhe shmangien e përdorimit të fjalëve të huaja.

Njohuri plotësuese dhe thellime për probleme të morfologjisë – emrit dhe përemrit – me trajtat e përdorimit të tyre (në shumës e njëjës).

Çështje të foljes në gjuhën shqipe – kategoria e kohës, mënyrës dhe vetës, me vëmendjen në qendër sidomos për foljet e parregullta.

Ndërtimi i fjalisë së thjeshtë dhe i fjalisë së përbërë – tiparet kryesore dhe marrëdhënie të ndryshme që ndërtohen brenda fjalisë së përbërë.

Qëllimi i lëndës:

Të thellohen mësimet që kanë marrë gjatë shkollimit parauniversitar për gjuhën shqipe, në radhë të parë për shqipen standarde dhe për gramatikën e saj. Të njihen më mirë tiparet kryesore të shqipes standarde, krahasuar me dialektet e shqipes së folur dhe të zotërohet në një shkallë më të lartë gramatika e shqipes. Kjo, sepse në përdorimin e shqipes standarde (edhe të disa modeleve të fjalive e të njëjësive të tjera gjuhësore në mjedisin tonë - në Kosovë) kanë vërshuar ndikime të panevojshme nga gjuhë të tjera, sidomos nga gjuhët sllave (serbisht, maqedonisht...), të cilat kanë shturur disa nga rregullat themelore të ndërtimit të fjalisë dhe të njëjësive më të vogla sintaksore. Të zhvillojnë më tutje aftësitë e të shprehurit të kulturuar dhe të përdorimit të lirshëm të gjuhës në interpretimin e përmbajtjeve çfarëdo (edhe të materieve në fushën e shkencave teologjike), për t'u inkuadruar në procesin e komunikimit në nivele të larta – në debate, diskutime shkencore e kulturore e të tjera. Të zotërojnë në një shkallë të mirë drejtshqiptimin dhe

drejtshkrimin.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:

Të njohë tiparet kryesore të shqipes standarde;

Të nxërë dhe të njohë rregullat kryesore të morfologjisë së pjesëve të ligjëratës dhe përdorimin e tyre sipas frymës së gjuhës shqipe;

Të zotërojë në një masë të mirë rregullat e drejtshkrimit dhe të drejtshkrimit standard;

Të komunikojë me lehtësi dhe me një nivel të dëshirueshëm intelektual në shqipen standarde;.

Të zotërojë në një masë të mirë terminologjinë teologjike në gjuhën shqipe dhe ta përdorë atë në interpretim dhe në debate për probleme të ndryshme në këtë fushë të dijes;

Të jetë i gatshëm të marrë pjesë aktive në debate kulturore dhe (eventualisht) të ligjërojë për çështje të besimit dhe të materies në libra teologjike;

Të zotërojë shqipen për ta përballuar me gjuhë të tjera (sidomos me gjuhën arabe) në interpretime dhe në komunikim.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjeratave, ushtrimeve dhe stimulimit të studentëve në diskutime interaktive.

PËRMBAJTJA E LËNDËS:

Java e parë:

Njohja me objektin e kursit dhe me literaturën e detyrueshme e ndihmëse.

Dialektet e shqipes dhe shqipja standarde.

Thellimi i njohjes së veçorive të shqipes standard në raport me dialektet.

Ushtrime në shkrimin e teksteve të shkurtra në dialekt dhe në shqipen standarde. Korrigjimi i përbashkët i gabimeve eventuale.

Java e dytë:

Probleme të shqipes standarde sot dhe të kulturës së gjuhës.

Probleme të drejtshkrimit të shqipes.

Literatura: 1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë 1974;

2. Norma letrare, botim i Akademisë së Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë i Shqipërisë, Prishtinë 1978;

3. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1976,

Java tretë: Probleme të morfologjisë: Pjesë të ligjëratës – të pandryshueshme e të ndryshueshme;

Emri dhe kategoritë gramatikore të tij: Gjinia, numri, trajta e pashquar/e shquar;

Shumësi i emrave të gjinisë femërore.

Java e katërt:

Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore (mënyrat kryesore të formimit të shumësit: trajta e pashquar dhe trajta e shquar);

Përdorimi i përcaktorëve / mbiemrave me emra të gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me prapashtesat: **-e** dhe **-ra**. (male, burime / ujëra, mallra/)

Java e pestë: Përemrat (vetorë, dëftorë, pyetës) – trajtat e njëjësit e të shumësit, lakimi i tyre:

Përemrat lidhorë – QË, I CILI.

Java e gjashtë:

Mbiemri në gjuhën shqipe:

Kategoritë e mbiemrit: gjinia, numri dhe përdorimi i tyre;

Formimi i mbiemrave;

Emërzimi – i mbiemrave (kontekstual dhe i plotë)

Java e shtatë:

Fjalë të para e të prejardhura: formimi me parashtesa e me prapashtesa dhe kompozimi: fjalë të përngjitura e kompozita.

Java e tetë: Kolokuium

Java e nëntë:

Folja – njohuri të përgjithshme: folje me kuptim të plotë leksikor dhe folje modale e gjysmëndihmëse; folje ndihmëse. Folje kalimtare e jokalimtare.

Trajtat kohore të foljes në mënyrën dëftore

Java e dhjetë:

Trajtat kohore të foljes në mënyrat habitore, lidhore, dëshirore e urdhërore

Probleme të zgjedhimit të foljeve të parregullta (bie/rashë - kam rënë, bie/prura – kam prurë; jap/dhashë-kam dhënë; shoh/pashë – kam pare; ha/hëngra – kam ngrënë; vij/erdha – kam ardhur

Java e njëmbëdhjetë:

Fjalja e thjeshtë – ndërtimi dhe përbërësit e saj: folja (kallëzuesi) dhe grupi emëror (emir – kryefjala) dhe përbërës të tjerë (përcaktori, kundrinori, rrethanorët).

Java e dymbëdhjetë:

Fjalja e përbërë - tiparet dhe veçoritë e fjalisë me bashkërenditje e me nënrenditje;

Fjalja e përbërë përcaktore – mjetet e lidhjes/përemra lidhorë.

Java e trembëdhjetë:

Fjalja e përbërë rrethanore – tipat dhe mjetet e lidhjes.

Java e katërbëdhjetë

Përmbledhje e njohurive për fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë.

Kriteret dhe komponentet e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: 10 pikë

Ese 10 pikë

Punime seminari: 10 pikë

Vlerësimi i kolokiumit: 20 pikë

Provimi final: 50 pikë

Literatura themelore – e detyrueshme:

1. Bahri Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Prishtinë 2001

Literaturë ndihmëse, plotësuese:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I*, Tiranë 2002;

2. *Gjuha shqipe*, revistë – Instituti Albanologjik I Prishtinës;

3. *Kulturë e gjuhës*, revistë – Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i detyruar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidence për studentët e rregullt). Studentët duhet të vijnë me kohë në ligjëratat, sepse vonesa e secilit shkakton çrregullim dhe shpërqendrim e dëmton rrjedhjen e ligjërimit dhe të ushtrimeve. Për orën e ushtrimeve studentët duhet të kryejnë detyrat e shtëpisë (detyrimisht një herë në dy javë), të cilat do të analizohen dhe vlerësohen botërisht, me këshillat e domosdoshme për korrigjimin e gabimeve dhe lëshimeve eventuale. Të gjithë studentët duhet të përfillin detyrimisht rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimin, shkyçja e telefonave celularë etj..

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohen për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.